Close

From
$57

The Villages at Ocean Edge Resort & Golf Club

Brewster

Reklame



Fillimi > Ligje > Ligje > Vendim i KM

S0 S0 g+1 0 Like 0 Share Tweet Share Favorite Email

Detajet e Aktit

Titulli:	**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 480, DATË 22.6.2011 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E RREGULLORES MODEL TË PLANIFIKIMIT"**
Tipi i Aktit:	Vendim i KM
Numri i Aktit:	371
Statusi i Aktit:	I ndryshuar
Data e Aktit:	02.05.2013
Data e aprovimit te Aktit:	02.05.2013
Numri i neneve:	--
Numri i fletores zyrtare:	75
Data e fletores zyrtare:	10.05.2013
Aktiviteti:	Rregullorja
Propozuar nga:	Këshilli i Ministrave
Pershkrimi i Aktit:	Në shtojcën 1 "Rregullorja model e planifikimit", bashkëlidhur vendimit nr. 480, datë 22.6.2011 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Permbajtja e Aktit

Permbajtja:

VENDIM
Nr. 371, datë 2.5.2013
PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 480, DATË 22.6.2011 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E RREGULLORES MODEL TË PLANIFIKIMIT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6 të nenit 88 të ligjit nr. 10 119, datë 23.4.2009 "Për planifikimin e territorit", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:
I. Në shtojcën 1 "Rregullorja model e planifikimit", bashkëlidhur vendimit nr. 480, datë 22.6.2011 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:
1. Pas shkronjës "d" të pikës 2 të nenit 2, shtohen shkronjat "dh" dhe "e" me këtë përmbajtje:
"dh) përcaktimin e përdorimit të lejuar të tokës deri në hartimin e instrumentit të përgjithshëm vendor të planifikimit;
e) përcaktimin e parametrave zhvillimorë të lejuar deri në hartimin e instrumentit të përgjithshëm vendor të planifikimit.".
2. Pas shkronjës "c" të pikës 1 të nenit 4, shtohet shkronja "ç" me këtë përmbajtje:
"ç) zhvillimin e strukturave me funksion administrativ në arsim, bujqësi, industri ushqimore, ekonomi ndihmëse bujqësore, shëndetësi, infrastrukturë, transport, e strukturave ushtarake, institucioneve fetare, shërbimeve tregtare, magazinave tregtare, shërbimeve sociale.".
3. Në pikat 2, 3, 4 dhe 6 të nenit 7, fjalët "... kategori ekzistuese të përdorimit të tokës ..." zëvendësohen me "... kategori ekzistuese dhe të lejuara të përdorimit të tokës ...".
4. Në pikën 1 të nenit 8, fjalët "... kategori ekzistuese të përdorimit të tokës ..." zëvendësohen me "... kategori ekzistuese dhe të lejuara të përdorimit të tokës ...".
5. Në shkronjën "a" të pikës 2 të nenit 9, fjalia "Intensiteti i ndërtimit të nënnjësisë strukturore" zëvendësohet me "Intensiteti i ndërtimit të nënnjësisë strukturore për kategorinë e tokës A. Banim".
6. Kudo në tekstin e rregullores, termi "Rregullore kombëtare e planifikimit" zëvendësohet me "Rregullore uniforme e instrumenteve të planifikimit".
II. Ngarkohen autoritetet e planifikimit, të përcaktuara në nenet 5 e 12 të ligjit nr. 10 119, datë 23.4.2009 "Për planifikimin e territorit", të ndryshuar, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.
KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Shfleto artikuj te tjere per:
MODELE, PLANIFIKIM, RREGULLORE, SHTESA,

Postuar nga: khoxha
Kontakto

ikub #:
1309010033